

Kushtet e përgjithshme të Komercijalna Banka AD Skopje për lëshimin dhe përdorimin e kartave të debitit për personat fizikë

1. Definicionet

- **Kushtet e përgjithshme** - Kushtet dhe rregullat e përgjithshme për lëshimin dhe përdorimin e kartave të debitit të Komercijalna Banka AD Skopje;
- **Banka** – Komercijalna Banka AD Skopje;
- **Institucionet e pagesave ndërkombëtare** – Mastercard® Worldwide dhe Visa International;
- **Kartë** - Kartë debiti të cilën Banka ia lëshon shfrytëzuesit të kartës;
- **Kartë plotësuese** - kartë e cila me kërkesë dhe autorizim të shfrytëzuesit të kartës themelore, i lëshohet shfrytëzuesit plotësues të kartës, i/e cili/a i përdor mjetet nga llogaria/llogaritë e shfrytëzuesit të kartës themelore;
- **Shfrytëzues i kartës** - person fizik të cilit Banka i ka lëshuar kartë debiti dhe emri i së cilit është i shënuar në kartë;
- **Shfrytëzues i kartës themelore** - shfrytëzues i kartës, pronar i llogarisë/ve i cili ngarkohet me harxhimet që dalin nga shfrytëzimi i kartës;
- **Shfrytëzues i kartës plotësuese** - shfrytëzues i kartës të cilit i është lëshuar kartë plotësuese me kërkesë dhe autorizim nga shfrytëzuesi i kartës themelore;
- **Llogari transaksionale** – llogari transaksionale në denarë e shfrytëzuesit të kartës themelore, e hapur në Bankë, e cila ngarkohet/miratohet për shumën e transaksioneve, harxhimeve, kompensimeve dhe interesave të cilat dalin nga përdorimi i kartës themelore dhe kartave plotësuese të debitit në R. e Maqedonisë së Veriut, dhe jashtë R. së Maqedonisë së Veriut, në qoftë se përdoren kartat e debitit Debit MasterCard World, Debit MasterCard dhe Visa Debit, gjegjësisht vetëm nga R. e Maqedonisë së Veriut nëse përdoret karta e debitit Maestro;
- **Llogari devizore** - llogari transaksionale devizore e shfrytëzuesit të kartës themelore e hapur në Bankë, e cila ngarkohet/miratohet për shumën e transaksioneve, harxhimeve, kompensimeve dhe interesave të cilat dalin nga përdorimi i kartës themelore dhe kartave plotësuese të debitit Maestro jashtë R. së Maqedonisë së Veriut;
- **Gjendja e mjeteve të lira në llogarinë transaksionale** - mjete të lira (mjetet vetanake dhe mjetet nga tejkalimi i lejuar/overdraft) të zvogëluara për të gjitha mjetet e rezervuara (për transaksionet e autorizuar por akoma të paregjistruara dhe rezervimet në baza të ndryshme);
- **Gjendja e mjeteve të lira në llogarinë devizore** - mjete të lira (mjetet vetanake) të zvogëluara për të gjitha mjetet e rezervuara (për transaksionet e autorizuar por akoma të paregjistruara dhe rezervim shtesë në vlerë prej 10 EUR për provizionet dhe kompensimet eventuale);
- **Limiti ditor** - shuma e mjeteve, numri i transaksioneve dhe shuma maksimale e transaksionit që Shfrytëzuesi i kartës mund ti përdorë çdo ditë, në tregti ose si para të gatshme;
- **Harxhimet** - të gjitha detyrimet për shumën e transaksioneve, harxhimeve, anëtarësive, kompensimeve dhe interesave që dalin nga shfrytëzimi i kartës themelore dhe kartave plotësuese;
- **Bankomat - ATM** - pajisje elektronike që mundëson tërheqjen e parave të gatshme, por edhe shërbime të tjera, pa prezencën fizike të punonjësve të Bankës;
- **Pikë shitjeje** - tregtar, i cili ka lidhur Marrëveshje për shitjen e mallrave dhe shërbimeve duke paguar përmes kartave nga programi i MasterCard Worldwide (MasterCard dhe Maestro) dhe/ose Visa International;
- **POS terminal** - pajisje elektronike e instaluar nëpër pika të shitjes ose në sportelet bankare që shërben për realizimin elektronik të transaksioneve;
- **PIN (Personal identification number)** - numri i fshehtë personal i identifikimit të shfrytëzuesit të kartës themelore, apo shfrytëzuesit të kartës plotësuese, që shërben për identifikim gjatë përdorimit të kartës nëpër bankomatet dhe терминалет POS;
- **Ditë e punës** - çdo ditë kur Banka dhe institucionet financiare në R. Maqedonisë së Veriut punojnë dhe realizojnë veprimtari financiare (Terminologjia e përdorur në njëjës mund të përdoret edhe në shumës por mund të jetë edhe e njëzuar, duke mos e humbur kuptimin e përcaktuar);

2. Lëshimi i kartës

- Karta mund ti lëshohet çdo personit fizik të aftë për biznes i/e cili/a i plotëson kushtet për marrjen e një karte debiti, dhe që është shtetas i R. së Maqedonisë së Veriut. Karta e debitit mund ti lëshohet edhe personit fizik që nuk është shtetas i R. së Maqedonisë së Veriut por në përputhje me rregullativën ligjore trajtohet si resident.

- Kartat e debitit Debit MasterCard World, Debit MasterCard dhe Visa Debit janë të lidhura me llogarinë transaksionale të kërkesit dhe të gjitha transaksionet e bëra me kartë, qoftë në vend apo jashtë RMV, ngarkohen nga kjo llogari.
- Karta e debitit Maestro, përveç llogarisë transaksionale është e lidhur edhe me llogarinë devizore të kërkesit dhe për të gjitha transaksionet e bëra me kartë në vend ngarkohet llogaria në denarë ndërsa për transaksionet jashtë RMV ngarkohet llogaria transaksionale devizore.
- Parashtruesi i kërkesës (Aplikuesi) duhet të ketë hapur ose të hapë një llogari transaksionale në Bankë, ndërsa për kartën e debitit Maestro duhet të ketë të hapur/të hapë edhe llogari devizore në EUR në Bankë.
- Aplikuesi dorëzon në Bankë Aplikacionin për kartë me prezencë fizike ose online përmes linkut për aplikim në ueb faqen e Bankës.
- Aplikuesi pajtohet që Banka të verifikojë të gjitha të dhënat e shënuara në Aplikacion, si edhe të japë informata shtesë në lidhje me të sipas nevojës.
- Banka vendos për lëshimin e kartës, duke mos qenë e obliguar t'i japë arsyetim Aplikuesit për vendimin e saj.
- Në qoftë se Aplikuesi e anulon kërkesën për lëshimin e kartës në periudhën pas miratimit të kërkesës dhe përpunimit të kartës, ai/ajo është i/e obliguar që ti paguajë Bankës të gjitha harxhimet që dalin nga procedura për lëshimin e kartës.
- Shfrytëzuesi i kartës është i detyruar menjëherë pas marrjes të nënshkruajë kartën me stilolaps, ku nënshkrimi duhet të jetë i njëjtë me nënshkrimin e dhënë në Aplikacion, në llogarinë transaksionale në denarë dhe/ose llogarinë devizore, dhe në letrën e njoftimit ose pasaportën. Shfrytëzuesi i kartës mbart të gjithë rrezikun dhe pasojat në rast të mosnënshkrimit të kartës.
- Afati i vlefshmërisë së kartës është i shënuar në kartë. Shfrytëzuesi mund të përdorë kartën derisa t'i skadojë afati i vlefshmërisë.

3. Shfrytëzuesi i kartës plotësuese

- Me kërkesë dhe autorizim të shfrytëzuesit të kartës themelore, Banka mund të miratojë lëshimin e një karte plotësuese. Shfrytëzuesi i kartës themelore mund të parashtrorë kërkesë dhe autorizim për lëshimin e kartës plotësuese, vetëm në qoftë se Shfrytëzuesi i kartës themelore është pronar i llogarisë transaksionale.
- Të gjitha harxhimet që dalin nga përdorimi i kartës themelore dhe asaj plotësuese ngarkohen në llogarinë transaksionale apo llogarinë devizore të shfrytëzuesit të kartës themelore.
- Shfrytëzuesi i kartës themelore mund të anulojë autorizimin dhe të ndërpresë të drejtën e përdorimit të kartës plotësuese, për çka është i detyruar të informojë me shkrim Bankën dhe t'a kthejë kartën plotësuese. Në rast se Shfrytëzuesi i kartës themelore nuk mund të kthejë kartën plotësuese, procedura për ndërprerjen e të drejtës për të përdorur kartën plotësuese realizohet në bazë të kërkesës me shkrim, prej ku bllokohet karta dhe ndërpritet mundësia për përdorimin e saj të mëtejshëm.

4. Ripërtrirja e kartës

- Nëse shfrytëzuesi i kartës u përmbahet Kushteve të përgjithshme, dhe nëse nuk anulon përtëritjen e kartës së paku 30 ditë para skadimit të vlefshmërisë së kartelës, karta automatikisht do të ripërtrihet dhe nuk ka nevojë të bëhet kërkesë për ripërtrirje të saj. Banka rezervon të drejtën, në bazë të analizave paraprake, të zëvendësojë llojin e kartës së debitit të klientit në favor të tij, me qëllim që klienti të ketë përfitime më të mëdha nga përdorimi i kartave. Gjatë këtij lloji të zëvendësimit të kartës, klienti nuk duhet të nënshkruajë kërkesë për kartë të re.
- Shfrytëzuesi i kartës është i obliguar të mbajë evidencë për afatin e vlefshmërisë së kartës. Në qoftë se nuk merr njoftim për kartën e ripërtrirë deri në fund të muajit të caktuar si afati i fundit i vlefshmërisë, është i detyruar të drejtohet në Bankë që të ripërtrijë të njëjtën.
- Shfrytëzuesi është i detyruar të shkatërrojë (presë) kartën e vjetër.
- Shuma e anëtarësisë vjetore për kartën themelore dhe kartat plotësuese ngarkohet në llogarinë transaksionale të shfrytëzuesit të kartës themelore. Tarifa vjetore e anëtarësisë për të gjitha llojet e kartave llogaritet çdo vit, por tarifohet çdo muaj me 12 shuma të barabarta mujore.

5. Përdorimi i kartës

- Karta nuk mund t'u transferohet personave tjerë dhe përdoret vetëm nga Shfrytëzuesi i kartës emri i së cilit/cilës është shtypur në kartë.

- Shfrytëzuesi mund të përdorë kartën për pagesa pa para të gatshme të produkteve dhe shërbimeve në të gjitha vendet e shitjes në R. e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj, në të cilat shfaqet shenja/logoja e MasterCard dhe/ose Visa.

- Për të gjitha përdorimet e kartave të debitit Debit MasterCard dhe Debit MasterCard World jashtë vendit, llogaritja bëhet në EUR, ndërsa debitimi bëhet në denarë në llogarinë në denarë të Përdoruesit, **me kursin e mesëm të këmbimit**, në përputhje me listen e kursit të këmbimit të Bankës që vlen në ditën e debitimit. Kur përdoret karta jashtë vendit, konvertimi i harxhimeve, nga valutat e tjera në EUR dhe nga EUR në denarë, pas autorizimit të transaksionit, bëhet në përputhje me kurset e këmbimit të MasterCard Worldwide.

Harxhimet e konvertimit të valutave bien në ngarkesë të Shfrytëzuesit të kartës.

- Për të gjitha përdorimet e kartës së debitit Visa Debit jashtë vendit, llogaritja bëhet në EUR, ndërsa debitimi bëhet në denarë në llogarinë në denarë të Përdoruesit, **me kursin e shitjes**, në përputhje me listën e kursit të këmbimit të Bankës, që vlen në ditën e debitimit. Kur përdoret karta jashtë vendit, konvertimi i harxhimeve, nga valutat e tjera në EUR dhe nga EUR në denarë, pas autorizimit të transaksionit, bëhet me kurset e këmbimit të Visa International.

Harxhimet e konvertimit të valutave bien në ngarkesë të Shfrytëzuesit të kartës.

- Për të gjitha përdorimet e kartës së debitit Maestro jashtë vendit, pa marrë parasysh valutën që përdoret në atë vend, duhet që Shfrytëzuesi i llogarisë devizore të ketë Euro. Kur përdoret karta jashtë vendit, konvertimi i harxhimeve, nga valutat e tjera në EUR, pas autorizimit të transaksionit, bëhet me kurset e këmbimit të MasterCard Worldwide.

Harxhimet e konvertimit të valutave bien në ngarkesë të Shfrytëzuesit të kartës.

- Për të përdorur kartën Debit MasterCard World për pagesa pa para të gatshme të produkteve dhe shërbimeve në të gjitha pikat e shitjes në R. e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë vendit, Banka llogarit në nivel mujor një rimbursim të mjeteve, i cili paguhet në formën e një Kartë-dhuratë, në momentin kur grumbullohen 1.000 denarë. Për qarkullim mujor të realizuar në tregti deri në 10.000 denarë, kthimi i mjeteve është 0,4% e qarkullimit të realizuar, ndërsa për qarkullim mujor mbi 10.000 denarë, 0,6% e qarkullimit të realizuar.

- Karta mund të përdoret edhe për tërheqjen e parave të gatshme në valutë domicile në të gjitha bankomatet dhe në të gjitha bankat në R. e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj, në të cilat shfaqet shenja/logoja e MasterCard dhe/ose Visa.

- Karta mund të përdoret edhe për pagesa në para të gatshme në llogari transaksionale me të cilën karta është e lidhur përmes bankomateve të Bankës.

- Përdorimi i kartës jashtë vendit bëhet në përputhje me Ligjin për punë devizore dhe dispozitave tjera të cilat rregullojnë punën devizore dhe rregulloret tjera në R. e Maqedonisë së Veriut.

- Gjatë përdorimit të kartës në bankomat, shfrytëzuesi i kartës identifikohet më kodin PIN, ndërsa në терминалет POS identifikohet me PIN dhe/ose nënshkrim, i cili duhet të jetë identik me nënshkrimin e dhënë në kartë.

- Një kopje të vërtetimit për shitblerje, Shfrytëzuesi i kartës e mban për evidencë të tij/saj.

- Të gjitha parregullsitë e vërejtura në vërtetimin e transaksionit të realizuar, Shfrytëzuesi duhet t'i qartësojë gjatë blerjes respektivisht gjatë shfrytëzimit të shërbimit.

- Shfrytëzuesi është i obliguar të mbajë për të paktën 6 muaj të gjitha dokumentet që lidhen me pagesat e bëra me kartë. Me kërkesë të Bankës, sipas nevojës, Shfrytëzuesi është i obliguar të dorëzojë në Bankë të gjitha dokumentet e kërkuara.

- Me kërkesë të shitësit të mallit respektivisht ofruesit të shërbimit, Shfrytëzuesi është i obliguar të legjitimohet me letër njoftimi ose pasaportë.

- Kodi PIN është i njohur vetëm për Shfrytëzuesin e kartës dhe i njëjti duhet të mbahet i fshehtë dhe asnjëherë të mos i zbulohet palës së tretë.

- PIN-i nuk duhet të shënohet në kartë, dhe të mos shkruhet asnjëherë në ndonjë letër e as të lihet ndonjë gjurmë e saj.

- Në rast të humbjes apo harresës së PIN-it, Shfrytëzuesi i kartës duhet menjëherë të drejtohet në Bankë ku do të merr PIN-in e ri.

6. Kushtet e pagesës

- Shfrytëzuesi i kartës mund të përdorë kartën deri në lartësinë e saldos së disponueshme në momentin e kryerjes së transaksionit ose në momentin e ngarkimit të llogarisë.

- Shfrytëzuesi i kartës themelore e autorizon Bankën që shpenzimet e shkaktuara nga përdorimi i kartës themelore dhe kartave plotësuese ti paguajë nga llogaria e tij/saj transaksionale apo nga llogaria devizore në valutën përkatëse.

- Shfrytëzuesi i kartës themelore, për pagesën e të gjitha shpenzimeve të arritura por të papaguara që mund të dalin në llogarinë transaksionale ose llogarinë devizore nga përdorimi i kartës themelore dhe kartave plotësuese, autorizon Bankën pa pëlqim plotësues të tij/saj, të bëjë urdhëresa për pagesë nga të gjitha llogaritë e hapura në Bankë në emër të Shfrytëzuesit të kartës themelore.
- Në qoftë se në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e përdorimit të kartës, Shfrytëzuesi i kartës nuk njoftohet për ngarkesat e shpenzimeve të bëra përmes raportit/pasqyrës së lëvizjeve në llogari, është i obliguar menjëherë të njoftojë Bankën.
- Banka cakton limitet ditore për përdorimin e kartës, për të cilat Shfrytëzuesi i kartës është i njoftuar që kur merr kartën. Banka rezervon të drejtën e ndryshimit të limiteve ditore.
- Me kërkesë të Shfrytëzuesit të kartës kryesore mund të caktohen limitet ditore të kartës për tregti dhe para të gatshme, limite këto të cilat mund të ndryshojnë nga limitet ditore të caktuara nga Banka. Kërkesa me shkrim për ndryshimin e limiteve ditore bëhet në sportelet e Bankës të caktuara për këtë qëllim, ose duke telefonuar në qendrën e kontaktit për karta, ku Banka ka mbështetje 24-orëshe, numri i së cilit është shënuar në pjesën e pasme të kartës, respektivisht 02/3247-474. Ekziston mundësia që në mënyrë të pavarur të ndryshohen limitet ditore nga shfrytëzuesi i kartës përmes internetit ose shërbimit m-banka.
- Përdorimi i kartës bëhet në kuadër të saldos së disponueshme respektivisht në kuadër të limitit ditor.
- Limiti ditor ka të bëjë me llogarinë transaksionale, ose kumulative për të dy llogaritë, pavarësisht valutës, në varësi të llojit të kartës së debitit.

7. Njoftimet për shfrytëzuesin e kartës

- Banka, përmes raportit/pasqyrës së gjendjes, njofton Shfrytëzuesin e kartës për të gjitha detyrimet lidhur me shumën e transaksioneve, harxhimeve, kompensimeve dhe interesave që dalin nga përdorimi i kartës themelore dhe kartave plotësuese.
- Shfrytëzuesi i kartës është i detyruar të paktën njëherë në muaj të marrë raport për gjendjen e llogarisë së tij/saj, të cilën e merr në sportelet e Bankës, në përputhje me Marrëveshjen për llogari transaksionale dhe llogari devizore.
- Për të gjitha informatat për përpunimin e kartës ose printimin e PIN-it, për shfrytëzuesit e rinj dhe ekzistues të kartave, Banka njofton klientin përmes SMS porosive, Internet Bankës, raportit/pasqyrës së llogarisë ose përmes qendrës për kontakt të Bankës.

8. Reklamacionet (ankesat)

- Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për cilësinë dhe sasinë e produkteve dhe shërbimeve të blera me kartën.
- Ankesat në lidhje me cilësinë dhe sasinë e produkteve dhe shërbimeve të blera me kartë zgjidhen në pikën e shitjes.
- Shfrytëzuesi duhet të paguajë harxhimet e përgjithshme për çdo llogari, pavarësisht ankesave.
- Nëse Shfrytëzuesi i kartës mendon se ndonjë shumë është llogaritur apo është regjistruar gabimisht, ose që nuk i përket atij/asaj, mund të drejtohet në Bankë duke dorëzuar llogaritë dhe dokumentet tjera relevante të cilat Banka mund t'ja kërkojë.
- Ankesat parashtrihen përmes plotësimit të një formulari të Bankës i cili dorëzohet pranë sporteleve të Bankës të caktuara për praninë të ankesave.
- Ankesat parashtrihen në afat prej 20 (njëzet) ditësh pas përfundimit të muajit kur është regjistruar transaksioni. Në të kundërtën, Banka konsideron se Shfrytëzuesi i kartës themelore pajtohet me harxhimet e përgjithshme të evidentuara në vërtetim.
- Nëse Banka konstaton se ankesa është e arsyeshme, atëherë do ta miratojë llogarinë e Shfrytëzuesit të kartës themelore, ndërsa në rast të ankesave të pajustificuara shfrytëzuesi i bart të gjitha kompensimet dhe harxhimet që dalin nga procedura e ankimit.
- Afatin për zgjidhjen e rastit të ankesës e cakton Banka në përputhje me rregullat e Visa International dhe MasterCard Worldwide.

9. Karta e humbur apo e vjedhur

- Shfrytëzuesi i kartës i bart të gjitha përgjegjësitë dhe pasojat ligjore në rast të përdorimit të paautorizuar të kartës.
- Shfrytëzuesi i kartës është i detyruar të respektojë masat e sigurisë gjatë përdorimit të kartës (p.sh. duhet të nënshkruajë kartën, ta ruajë kodin PIN në fshehtësi të plotë, dhe kurrë mos e mbajë PIN-in së bashku me kartelën ose në një vend të dukshëm, etj.)

- Shfrytëzuesi i kartës duhet menjëherë ta njoftojë Bankën nëse karta është vjedhur apo humbur në tel. 02/3247-474, dhe në të njëjtën kohë ta paraqesë edhe më shkrim në Zyrën Qëndrore të Bankës - Shërbimi për karta bankare ose në njësitë tjera organizative të Bankës - degët dhe filialet e Bankës.
- Në rast të humbjes apo vjedhjes së kartës, Shfrytëzuesi i kartës bart përgjegjësinë financiare për shpenzimet e bëra nga karta, gjegjësisht 300 minuta pas paraqitjes së parë të humbjes apo vjedhjes së kartës.
- Nëse Shfrytëzuesi i kartës nuk i përmbahet detyrimit të fshehtësisë apo nuk respekton masat e sigurisë gjatë përdorimit të kartës, atëherë ai/ajo është vetë përgjegjës për çdo keqpërdorim eventual të kartës.
- Pas marrjes së kërkesës me shkrim për humbjen/vjedhjen e kartës, Banka i lëshon Shfrytëzuesit një kartë të re. Çdo harxhim lidhur me lëshimin e kartës së re dhe/ose PIN-it të ri pas humbjes/vjedhjes së kartës, e bart Shfrytëzuesi i kartës, në përputhje me Vendimin për Tarifat e kompensimeve të Bankës.
- Nëse Shfrytëzuesi, pas raportimit të kartës si të humbur/vjedhur, e gjen kartën e vjetër, të njëjtën nuk duhet ta përdorë por është i obliguar ta presë dhe ta dorëzojë në Bankë. Harxhimet e bëra nga përdorimi i kartës së pavlefshme të gjetur ngarkohen në llogarinë e Shfrytëzuesit të kartës.

10. Ndërprerja e të drejtës së përdorimit të kartës

- Karta është pronë e Bankës dhe me kërkesë të saj Shfrytëzuesi i kartës është i detyruar menjëherë të kthejë kartën të prerë. Karta bankare afati i së cilës ka skaduar apo është anuluar nuk mund të përdoret. Banka mund të vendosë të ndërpresë (përgjithmonë apo përkohësisht) të drejtën e përdorimit të kartës, ose të vendosë të anulojë kartën në rastet e mëposhtme:
 - kur Shfrytëzuesi i kartës tre herë radhazi shënon kodin PIN gabim;
 - kur është paraqitur vjedhja/humbja e kartës në rastet kur Shfrytëzuesi ka përdorur kartën duke mos respektuar Kushtet e përgjithshme;
 - kur në llogarinë transaksionale apo në llogarinë devizore nuk ka mbulesë për pagesë të shpenzimeve të bëra apo kur të njëjtat janë joaktive; dhe
 - në të gjitha rastet tjera për të cilat Banka vlerëson se duhet të veprojë në atë mënyrë duke mos qenë e obliguar të japë arsye.
- Pika e shitjes mund të mbajë kartën dhe t'a dorëzojë në Bankë nëse kartën e përdor person tjetër që nuk është caktuar si Shfrytëzues i kartës, nëse Banka ka dhënë urdhëresë për marrje të kartës ose nëse kartës i ka skaduar afati i vlefshmërisë.
- Në qoftë se Banka anulon kartën themelore të Shfrytëzuesit, të gjitha kartat tjera plotësuese bëhen të pavlefshme.
- Shfrytëzuesi i kartës themelore mund në çdo kohë të ndërpresë përdorimin e kartave duke dorëzuar një deklaratë të nënshkruar (me shkrim) në Bankë, në sportelet e caktuara për atë qëllim dhe duke kthyer kartën themelore dhe kartat plotësuese.
- Në qoftë se Shfrytëzuesi i kartës themelore dëshiron të ndërpresë përdorimin e kartës plotësuese, atëherë është i obliguar të njoftojë Bankën duke nënshkruar kërkesën me shkrim, të dorëzuar në sportelet e caktuara për atë qëllim, dhe duke kthyer kartat themelore dhe plotësuese në Bankë.
- Në rast të ndërprerjes së përdorimit të kartës themelore dhe kartave plotësuese, Shfrytëzuesi i kartës themelore është i detyruar t'i paguajë të gjitha detyrimet e papaguara të kartës, që kanë qenë deri në momentin e funksionimit të rregullt të kartës.

11. Kompensimet dhe provizionet

- Të gjitha kompensimet dhe provizionet e lidhura me kartën realizohen në përputhje me Vendimin për tarifat e kompensimeve të Bankës. Për shumën e kompensimeve dhe provizioneve të përlogaritura ngarkohet llogaria transaksionale në denarë apo llogaria devizore në vendin e kryerjes së transaksionit dhe llogarinë përkatëse dhe të njëjtat evidentohen në raportin/pasqyrën e gjendjes së llogarisë.

12. Dispozita të tjera

- Kushtet e përgjithshme janë pjesë përbërëse e Aplikacionit (Kërkesës) për lëshimin e kartës së debitit dhe luajnë rolin e Marrëveshjes.
- Me nënshkrimin e Aplikacionit (Kërkesës) Shfrytëzuesi i kartës i pranon Kushtet e përgjithshme dhe deklaron se i ka të qarta dhe se i pranon të njëjtat.
- Dispozitat e Kushteve të përgjithshme i referohen Shfrytëzuesit të kartës themelore si edhe çdo Shfrytëzuesi të kartës plotësuese.
- Banka dhe Institucionet për pagesa ndërkombëtare rezervojnë të drejtën për të implementuar privilegje/shërbime plotësuese për shfrytëzuesit e kartave, si dhe për t'i anuluar ato përkohësisht ose plotësisht pa njoftim paraprak dhe pa pëlqimin e Shfrytëzuesit. Nëse bëhet fjalë për një privilegj/shërbim

të mundësuar nga Institucionet e pagesave ndërkombëtare, Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për përmbushjen e tij. Të gjitha privilegjet/shërbimet për shfrytëzuesit e kartave, duke përfshirë edhe ndryshimet e tyre, do të publikohen në ueb faqen e Bankës.

- Banka rezervon të drejtën për të ndryshuar Kushtet e përgjithshme si dhe Tarifën për kompensimin e shërbimeve të Komercijalna Banka AD dhe Vendimin për normat e interesit të Komercijalna Banka AD në përputhje me politikën e biznesit të Bankës, ndërsa për këto ndryshime dhe plotësime do të njoftojë klientët/shfrytëzuesit e saj përmes ueb faqes së Bankës ose përmes Raporteve të gjendjes së llogarisë transaksionale apo llogarisë devizore.

- Shfrytëzuesi i kartës i cili nuk pajtohet me ndryshimet e Kushteve të përgjithshme është i detyruar të kthejë kartën në Bankë, të shkatërruar. Me këtë ndërprehet edhe marrëdhënia kontraktuale midis Bankës dhe Shfrytëzuesit të kartës.

- Nëse Shfrytëzuesi nuk e kthen kartën në afat prej 15 ditëve pas kalimit të muajit në të cilën është bërë ndryshimi i Kushteve të përgjithshme, do të konsiderohet se i pranon këto ndryshime.

- Shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë të gjitha harxhimet që kanë dalë deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies kontraktuale.

- Të drejtat dhe detyrimet e kontraktuara për Bankën hyjnë në fuqi prej ditës së parashtrimit të kërkesës.

- Të drejtat dhe detyrimet lidhur me përdorimin e kartës hyjnë në fuqi prej ditës së nënshkrimit të pranimit të kartës nga Shfrytëzuesi i kartës.

- Banka nuk mban asnjë përgjegjësi nëse Shfrytëzuesi i kartës nuk mund të përdorë kartën në disa raste të cilat janë jashtë kontrollit nga ana e Bankës si p.sh.:

- probleme teknike me pajisjet, sistemin, telekomunikacionin dhe rrymën;

- grevë ose rrethana të tjera të jashtëzakonshme;

- kur karta është bllokuar në ndonjë terminal të pikave të shitjes ose bankomat dhe e njëjta është dëmtuar;

- kur për çfarëdo lloj arsye, terminali i pikave të shitjes, banka apo bankomati nuk e pranon kartën;

- nëse ka kufizime nga institucionet e pagesave ndërkombëtare për realizimin e transaksioneve.

- Banka është e detyruar të ruajë të dhënat personale të Shfrytëzuesit të kartës në përputhje me dispozitat ligjore.

- Shfrytëzuesi i kartës themelore është i detyruar menjëherë të informojë Bankën për çdo ndryshim të adresës, punësimit apo për çdo informacion tjetër eventual që mund të ndikojë në përdorimin e kartës.

- Në rast të moslajmërimit për ndryshimin e adresës, dërgimi do të bëhet në adresën e regjistruar fillimisht e cila do të konsiderohet si adresë e rregullt dhe valide.

- Çdo përdorim i kartës që është në kundërshtim me Kushtet e përgjithshme sjell në mënyrë automatike marrjen e kartës themelore dhe kartave plotësuese, ndërmarrjen e masave të nevojshme në përputhje me dispozitat ligjore, ndërsa dëmi i përgjithshëm material sëbashku me interesat bie mbi Shfrytëzuesin e kartës themelore.

- Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje mes Bankës dhe Shfrytëzuesit të kartës, çështja do të zgjidhet në gjykatën kompetente në Shkup.